



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
DIBER

DETYRË PROJEKTIMI

OBJEKTI:

STUDIM PROJEKTIM NDËRTIMI UJËSJELLËSI RAJONAL NGA BURIMET E PERROIT TË LOPËS DHE GURRAVE TË KETËS FAZA II, BASHKIA KLOS.

VENDODHJA: Objekti ndodhet ne Bashkine Klos dhe shtrihet ne fshatrat qe perfshihen nga furnizimi i dy burimeve (Perroi i Lopes dhe Kete) qe jane Bel-Unjate, Dars, Gullqet, Plani i Bardhe, Klos Katund, Fshati Fshat,dhe Shengjun.

QELLIMI: Perfshin gjithë rrjetin shperndares per te mbyllur gjithë ciklin e rrjetit te ujesjellesit ne kete zone per te furnizuar me sasi dhe cilesi 24-ore popullsine prej rreth 3700 banore në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës fshatrat Bel-Unjate, Dars, Gullqet, Plani i Bardhe, Klos Katund, Fshati Fshat,dhe Shengjun, ne Bashkine Klos

1.1 TE DHENAT KRYESORE:

Projekti i zbatimit duhet te kete për qëllim sigurimin e furnizimit me ujë të besueshëm dhe higjenikisht të sigurt , prezantimin e tarifave të pranueshme shoqërore që mbulojnë të paktën kostot e operim dhe mirembajte.

Qëllimi i përgjithshëm është të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës rurale në njesine Bashkine Klos.

Objektivat e ketij projekti brenda, janë përmbledhur me poshtë:

- Furnizimi i klienteve me uje sipas Legjislacionit Shqiptar dhe kriterëve minimale te meposhtme: furnizim 24 ore me presion te mjaftueshem (min 15 m ne dalje ne cesmen e konsumatorit) me uje me cilesi sipas Standarteve Shqiptare dhe udhezimeve te EU.,
- Sigurimi i nje skeme te projektuar per operim me gravitet
- Eleminimi i puseve dhe elektropompave
- Projektimi i rrjetit shperndares per te siguruar uje ne lidhjet e konsumatoreve me presion minimal prej 1.5 bar m dhe max 6.0 bar
- Projektimi i nje sistemi me jetegjatesi ekonomike prej 25 vjetesh per tubat dhe ndertimet.
- Projektimi i sistemit ne menyre qe punimet e riparimit, mirembajtjes dhe operimit te kene nje kosto minimale.
- Projektimi i sistemit te furnizimit per nje perspektive 25 vjecare
- Furnizmin me uje 24 h te zonave per te cilat do ti sherbeje ky rrjet ujesjellesi

- Rritja e popullsisë në vite do të merret sipas të dhënave të fundit të INSTAT.
- Te kërkesën për plotësimin me ujë të pishëm të zonës, e cila ka për qëllim zhvillimin e turizmit malor dhe rekreacioni
- Projektimi i sistemit të furnizimit për një perspektivë 25 vjeçare

1.2 VENDNDODHJA

Fshatrat: Bel-Unjate, Dars, Fullqet, Plan I Bardhe, Klos katund, Fshati Fshat dhe Shengjun.
Qarku Diber, Bashkia Klos.

Vendndodhja: Fshatrat Bel-Unjate, Dars, Fullqet, Plani I Bardhe, Klos Katund, Fshati sat, Dhe Shengjun të cilat ndodhen në qytetin e Klosit.



Burimet e Perroit të Lopes, Klos Mat.



Burimet e Ketes, Klos.

1.3 PERSHKRIMI I SITUATES AKTUALE:

Aktualisht sot po ndertohen linjat e trasmetimit, si dhe infrastruktura e tyre, ku perfshin veprat e marrjes, depot e grumbullimit, klorifikimi dhe depot per cdo fshat per objektin NDERTIMI UJESJELLESI RAJONAL NGA BURIMET E PERROIT TE LOPES DHE GURRAVE TE KETES FAZA II, BASHKIA KLOS.

1.4 QELLIMI I PUNES

Per realizimin e projektit, projektuesi te mbeshtetet tek detyra e projektimit , duhet te rishikojte te gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin qe duhet te hartojte per furnizimin me uje sipas detyres projektimit dhe te konsultohet me njesine e qeverisjes vendore dhe Bashkine Klos.

Qellimi i ketij studimi eshte hartimi i projekt zbatimit te ujesjellesit (rrjeti i shperndarjes) te zones Klosit ku ne kete faze do te perqendrohet ne detaje te rrjetit te shperndarjes qe do te perfshije te gjithë linjen e brendeshme qe do te kompletoje rrjetin total per furnizimin me uje 24 ore ne te gjithë fshatrat Bel-Unjate, Dars, Fullqet, Plani I Bardhe, Klos Katund, Fshati Fshat,Dhe Shengjun te cilat ndodhen ne qytetit e Klosit.

Cilesia e studim projektimit duhet te jete e tille qe te arrihet standarti i kerkuar dhe te plotesojte kushtet e projektimit.

1.5 KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI:

Projekt-zbatimi i objektit: “NDERTIMI UJESJELLESI RAJONAL NGA BURIMET E PERROIT TE LOPES DHE GURRAVE TE KETES FAZA II, BASHKIA KLOS” duhet te permbaje:

- ✓ Relacion teknik te ujesjellesit
- ✓ Relacion gjeologjik dhe Hidrogjeologjik.
- ✓ Projektin e zbatimit ku perfshihen planimetria, profilet gjatesore, terthore te linjave te tuabcioneve te rrjetit shperndares
- ✓ Specifikime teknike

Vizatimet

Vizatimet e domosdoshme per tu paraqitur jane:

- 1.Horografia
- 2.Planimetria e rrjetit kryesor dhe shperndares,
- 3.Profilat gjatesor te rrjetit kryesor dhe shperndares shoqeruar me seksionin terthor tip, shkalle
- 4.Detaje ne shkalle
- 5.Relacioni teknik i projekt zbatimit.
- 6.Specifikimet teknike te zbatimit te punimeve dhe te materialeve qe do te perdoren sipas projektit.
7. Preventivi i punimeve ne perputhje me cmimet orientuese te udhezimit te K.M, si dhe burimet e materialeve te ndertimit.
- 8.Analizat perkatese te cmimeve te preventivit.
- 9.Projekt preventivi te paraqitet ne dy kopje dhe ne forme dixhitale.

1.6 REKOMANDIME PËR PROJEKTUESIN

- ✓ Projektuesi duhet të përdorë dhe rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me realizimin sa më të plotë të këtij projekti.
- ✓ Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje dhe atyre gjatë zbatimit.
- ✓ Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standarteve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.
- ✓ Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

1.7 ORGANIZIMI, PLANI PUNËS

- ✓ Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me stafin e inxhinierëve ne Shoqërinë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Dibër Sh.a.
- ✓ Vizatimet do të paraqiten në shkallën e përshtatshme dhe të lexueshme e caktuar kjo nga projektuesi .

